

BREAKING NEWS

EMËROHET NË KRYE TË ‘DONACIONEVE TË HUAJA’, YURI KIM LARGOHET NGA SALLA MENJËHI



AKTUALITET

Të shtëna me armë në Kamëz, 32-vjeçari tentoi të vriste të riun, Policia zbardh ngjarjen

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
19 NËNTOR 2021



Policia ka dhënë detaje për ngjarjen e ndodhur mbrëmë në bulevardin “Nënë Tereza”, në Kamzë dhe parandalon përshkallëzimin e një konflikti me pasoja të rënda për jetën.

Kapet dhe vihet në pranga 32-vjeçari, i cili për motive të dobëta qëlloi me pistoletë për ta vvarë një shtetas, pas një konflikti të çastit.

Policia gjeti dhe sekuestroi armën e zjarrit pistoletë me të cilën dyshohet se 32-vjeçari qëlloi në drejtim të 23-vjeçarit.

Në vijim të informacionit paraprak të dhënë mbrëmjen e djeshme për një konflikt të çastit të ndodhur në bulevardin “Nënë Tereza”, në Kamzë, si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore dhe profesionale u bë e mundur zbardhja e konfliktit dhe parandalimi i mëtejshëm i këtij konflikti me pasoja të rënda për jetën.

Si rezultat u bë i mundur identifikimi, kapja dhe arrestimi në flagrancë për veprat penale “Vrasja me dashje” e mbetur në tentativë dhe “Armëmbajtja pa leje”, i shtetasit E. S., 32 vjeç, banues në Kamzë.

Ky shtetas, në bulevardin “Nënë Tereza”, në Kamzë, dyshohet se ka qëlluar për motive të dobëta, me armë zjarri në drejtim të shtetasit I. I., 23 vjeç, banues në Bathore, i dënuar më parë për vjedhje.

Shtetasi E. S., në një distancë rreth 50 metra, ka qëlluar me armë zjarri pistoletë në drejtim të shtetasit I. I., i cili në momentet e para, nuk e ka deklaruar këtë fakt në Polici.

Shërbimet e Policisë, gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, kanë gjetur dhe sekuestruar një gëzhjojë dhe më pas gjatë arrestimit të shtetasit E. S., kanë gjetur dhe sekuestruar edhe armën e zjarrit pistoletë me fishekë luftarak.

Materialet procedurale do t’i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprën penale “Vrasja me dashje” e mbetur në tentativë dhe “Armëmbajtja pa leje”.

Më të lexuarat



Del fotot e vitit 2016, si u ekzekutuan brenda 2 vitesh miqtë Malko-Mihasi



Gazetari: Berisha shpërdoroi pushtetin, s’mund të përcaktojë sërish fatin tonë



“Njëres do i jap 50 euro, tjetrës 100, plas skandali në Sarandë: 14-vjeçarja shfrytëzohej për prostitucion




Vrasja e dyfishtë në Astir, eksperti i sigurisë: Krimi është trimëruar dhe ndihet i sigurt, kjo ndodh për shkak të lidhjes me policinë




Profesori i njohur reagon ashpër ndaj Berishës: Një sociopat, që po djeg partinë për të shpëtuar veten! Ja pse Rama nuk duhet të gëzohet me këtë tragjedi që po ndodh në PD!




Publikohet pamjet, ja si u ekzekutua Erigers Mihasi dhe Armando Dumani, qytetarët vrapojnë të tmerruar sapo dëgjojnë breshërinë e plumbave, kush i ndihmoi autorët (Video)




Arian Çani paralajmëron zhvillime të forta: Berisha dhe Basha dinë gjëra për njëri tjetrin! Do hapen barqet...




A do të bashkohet Kosova me Shqipërinë? Baton Haxhiu jep mesazhin e fortë




Artur Zheji “zbërthen” deklaratën e fortë të Sali Berishës: Ka bërë një gabim taktik! Ja mjegulla që po tenton ti hedhë opinionit publik



Aksidenti tragjik në Bullgari, kompanisë “Besas Trans” i hiqet licenca e punës



Arian Çani zbulon politikanin e njohur që do ti bashkohet Sali Berishës



“Tërbohet” moti, paralajmërojnë meteorologët: Ciklone të fuqishme mbërrijnë në Evropë! Ja çfarë e pret Shqipërinë nga dita e premte

Mesazhe Promocionale

Gossip




■ ■ ■ ■ ■

Einxhel Shkira shpërthen në lot: Dolën fjalët e babit tim! Kjo s’është më një lojë këtu

Einxhel Shkira nuk po e përjeton mirë ditën e sotme sepse i duket...

Opinione



OSMAN LUGA

Ujin e pinë të gjithë, por shëndet i jep atij q...



DR. MINELLA ALEKSI

Gjarpërinjtë me kostume



VANGJEL SAKO

Politikanët shqiptarë, gënjeshtren e mbajnë në ...



ANTON BELI

Komshinjtë e Gjirit të Lalzit i ka zënë halli ...

LEXO OPINIONE TE TJERA